



BASHKIA HIMARË

RELACION TEKNIK

“RIKUALIFIKIMI I QENDRËS FSHATI VRANISHT, LOTI 2”

PROJEKT ZBATIMI

PROJEKTUES:

B.O.E "HYDRO-ENG CONSULTING" sh.p.k & "SIRE-ALB" SH.P.K & "ENGINEERING CONSULTING GROUP" sh.p.k



1.1. HYRJE



Vranishti gjendet rrëzë maleve, në Lumin e Vlorës. Fshati është në mes të majave të larta, maleve të mbuluara shpesh me re, nga merr kuptim edhe emri i tij (kohë e vranët). Është kthyer në traditë festive tashmë edhe "Dita e Vranishtit", e cila zhvillohet në muajin Gusht që përkon edhe me kthimin e emigrantëve. Të gjithë mblidhen, çmallen, argëtohen duke respektuar traditat dhe njëri tjetrin. Ky fshat ka një bukuri natyrore të veçantë, ndër to si objekt natyror i jashtëzakonshëm është edhe "Guri me Qiell". Ai ndodhet në majën e Malit të Lipës, duke kaluar nën një shteg kafshësh. Prej lartësisë ku ndodhet ky monument i natyrës, spikat një pjesë e madhe e luginës së Lumit të Vlorës. Studiuesit thonë se: "Guri me Qiell" është një monument prehistorik, që lidhet me periudhën e neolitit të vonë dhe me epokën e bronzit, që shkon deri në 4-9 mijë vjet më parë. Një interpretim tjetër sipas legjendave të zonës, thuhet se kjo vepër ka lidhje me kultet mbivarrore si dhe atë të Diellit. Ai është një gur i stërmadh gjigand që duket sikur është vendosur nga dora e njeriut mbi dy shkëmbinj të tjerë, duke krijuar trajtën e një tryeze që legjendat thonë se është "Tryeza e Perëndive". Guri ka formën e një paralelopipedi me një peshë që mund të shkojë deri në 10 tonë, ndoshta edhe për këtë arsye emërtohet ndryshe edhe "Sofra e Zotit". Banorët e zonës e konsiderojnë atë si një dhuratë e natyrës për një vend të ashpër malor, si kundër është Lumi i Vlorës me fshatrat e veta. Nga ana tjetër ky monument është i vendosur përballë malit të Bogonicës, që njihet si "Vendi i Zotit". Kjo etimologji sipas muzeologëve përbën edhe një nga gjërat e veçanta të këtij monumenti, i cili qëndron në një mjedis mjaft të pasur me histori të ngjashme. Pak më tej ndodhet vendi që emërtohet "Lëmi i Lejlerëve", një vend i shenjtë që yjen



nga periudha pellazge i emërtuar ndryshe "Pjella e bardhë". Në një drejtim tjetër është edhe shpella dikur e banuar, e Lipës. Ky gur vlerësohet si një nga monumentet e rëndësishme i cili është eksploruar shumë pak. Përveçse banorëve vendas e atyre nga Vlora, si dhe studjuesve, "Guri me Qiell" ka zgjuar interesin e mjaft të huajve. Deri para pak vitesh, në vendin ku ndodhet "Guri me Qiell", vinin çdo verë një numër i konsiderueshëm turistësh e studiuesish francezë.

1.2. POZICIONI I OBJEKTIT




Objektet që do të nënshtrohen rikualifikimit janë godinat te sheshi i fshatit Vranisht, njësia administrative Horë-Vranisht, pjesë e bashkisë Himarë.



1.3. GJENDJA EKZISTUESE GODINA 1 (QENDER KULTURORE MULTIFUNKSIONALE)



"RIKUALIFIKIMI I QENDRËS FSHATI VRANISHT, LOTI 2"



1.4. PROBLEMATIKAT E OBJEKTIT

Permes verifikimeve ne terren vihet re se objekti shfaq keto probleme:

- Çarje në muret mbajtëse
- Degradim i muraturës
- Suva e jashtme dhe e brendshme e dëmtuar dhe e zhveshur
- Dëmtime në soletë/tavan
- Infiltrim uji nga soleta
- Njolla lagështie dhe myk në tavan dhe mure
- Degradim i materialeve për shkak të lagështisë së vazhdueshme
- Mungesë sistemi funksional të kullimit të ujërave (ulluqe)
- Dëmtim i shtresave të dyshemesë
- Dritare të amortizuara
- Hapësira të brendshme jashtë funksioni dhe të papërdorshme
- Rrezik shembjeje lokale nga elementë të dëmtuar





1.5. ZGJIDHJA DHE PUNIMET QE DO TE KRYHEN

Nga problematikat qe u shqyrtuan me lart zgjidhjet do te jene:

- Konsolidimi i muraturës ekzistuese
- Riparimi i çarjeve me teknika përforcuese
- Përforcim i elementëve mbajtës sipas nevojës
- Riparimi ose rindërtimi i soletës së dëmtuar
- Vendosja e sistemit të ri hidroizolues në çati
- Riparimi i shtresave të çatisë dhe veshjes përfundimtare
- Vendosja e ulluqeve dhe tubave shkarkues
- Trajtimi i mureve kundër lagështirës dhe mykut
- Suvatim i ri i brendshëm dhe i jashtëm
- Rindërtim i shtresave të dyshemesë
- Zëvendësimi i dritareve dhe dyerve
- Lyerje me bojë hidroplastike për ambientet e brendshme
- Vendosje e izolimit termik në çati dhe fasadë
- Eliminimi i urave termike
- Përmirësim i ventilimit natyral
- Pastrim dhe largim i mbetjeve inerte
- Sistemim i terrenit përreth objektit
- Rrjet i ri elektrik dhe ndriçim
- Sistem hidrosanitar i ri
- Ventilim dhe ajrosje e ambienteve
- Riorganizim i hapësirave sipas funksionit të ri
- Përshtatje me standardet për akses



1.6. GJENDJA EKZISTUESE GODINA 2 (QENDËR SHËNDETESORE)




1.7. PROBLEMATIKAT E OBJEKTIT

Permes verifikimeve ne terren vihet re se objekti shfaq keto probleme:

- Çarje në muret mbajtëse
- Degradim i muraturës
- Suva e jashtme dhe e brendshme e dëmtuar dhe e zhveshur
- Dëmtime në soletë/tavan
- Infiltrim uji nga soleta
- Njolla lagështie dhe myk në tavan dhe mure
- Degradim i materialeve për shkak të lagështisë së vazhdueshme
- Mungesë sistemi funksional të kullimit të ujërave (ulluqe)
- Dëmtim i shtresave të dyshemesë
- Dritare të amortizuara
- Hapësira të brendshme jashtë funksioni dhe të papërdorshme
- Rrezik shembjeje lokale nga elementë të dëmtuar







"RIKUALIFIKIMI I QENDRËS FSHATI VRANISHT, LOTI 2"



"RIKUALIFIKIMI I QENDRËS FSHATI VRANISHT, LOTI 2"





1.8. ZGJIDHJA DHE PUNIMET QE DO TE KRYHEN

Nga problematikat qe u shqyrtuan me lart zgjidhjet do te jene:

- Konsolidimi i muraturës ekzistuese
- Riparimi i çarjeve me teknika përforcuese
- Përforcim i elementëve mbajtës sipas nevojës
- Riparimi ose rindërtimi i soletës së dëmtuar
- Vendosja e sistemit të ri hidroizolues në çati
- Riparimi i shtresave të çatisë dhe veshjes përfundimtare
- Vendosja e ulluqeve dhe tubave shkarkues
- Trajtimi i mureve kundër lagështirës dhe mykut
- Suvatim i ri i brendshëm dhe i jashtëm
- Rindërtim i shtresave të dyshemesë
- Zëvendësimi i dritareve dhe dyerve
- Lyerje me bojë hidroplastike për ambientet e brendshme
- Vendosje e izolimit termik në çati dhe fasadë
- Eliminimi i urave termike
- Përmirësim i ventilimit natyral
- Pastrim dhe largim i mbetjeve inerte
- Sistemim i terrenit përreth objektit
- Rrjet i ri elektrik dhe ndriçim
- Sistem hidrosanitar i ri
- Ventilim dhe ajrosje e ambienteve
- Riorganizim i hapësirave sipas funksionit të ri
- Përshtatje me standardet për akses

PERGATITI:

B.O.E "HYDRO-ENG CONSULTING" sh.p.k & "SIRE-ALB" SH.P.K & "ENGINEERING CONSULTING GROUP" sh.p.k

